## ÇFARË NDODH GJATË NJË KONSULTE GJINEKOLOGJIKE?

Gjinekologu është një specialist për gratë i cili mund të kryejë lloje të ndryshme ekzaminimesh.

- EKZAMINIM I QAFË SË MITRËS
- EKZAMINIM VAGINAL
- PALPACION I GJIRIT

Pacienti duhet të qëndrojë shtrirë. Edhe pse këto ekzaminime mund të jenë të sikletshme, ato janë e vetmja mënyrë për të dalluar disa anomali. Nëse ndjeni ndonjë dhimbje apo shqetësim, mos hezitoni t'i tregoni specialistit. Ju lejohet të qëndroni veshur sipër në fillim të ekzaminimit.



## KËTO PJESË TË TRUPIT MERITOJNË NJË VËMENDJE TË VEÇANTË...

### NGA JASHTË




### NGA BRENDA




MODELI I PRERJES TËRTHORE TË GJIRIT




## KUSH MUND T'A KRYEJË KONTROLLIN TUAJ GJINEKOLOGJIK?

- Doktori i familjes me profesion gjinekologjinë
- Gjinekologu i spitalit
- Mamia
- Planifikimi familjar (EDHE PA SIGURIM MJEKËSOR)

Document realisé avec le soutien financier de Santé Publique France

# PËRSE DUHET TË KRYEJ NJË KONTROLL GJINEKOLOGJIK?

# PËRSE DUHET TË KONSULTOHEM ME GJINEKOLOGUN NËSE NUK JAM SËMURË?

Konsultat e rregullta, edhe kur gjithçka duket në rregull, është mënyra e vetme për parandalimin e disa sëmundjeve (kryesisht kancerit të gjirit dhe kancerit të qafës së mitrës) në çfarëdo moshe dhe jete seksuale.

## Kanceri i qafës së mitrës

Grupi i viruseve i quajtur «virusi njerëzor papiloma» apo «HPV» është përgjegjës per lezionet parakanceroze ose kanceroze në qafën e mitrës : Vetëm një pap test mund ta dallojë atë Në Francë, rekomandohet që pap testi të kryhet. **çdo 3 vjet, nga mosha 25 deri në 65 vjeç.** Ka një vaksinë kundër HPV-së për gratë e reja nga mosha 11 vjeç e sipër

PYESNI DOKTORIN TUAJ PËR MË SHUMË INFORMACION.

## Pap testi: një ekzaminim i thjeshtë

Gjinekologu fut një pasqyrë kirurgjikale (një retraktor plastik) dhe një furçë të vogël ose kunjë të gjatë pambuku në vaginë me qëllim marrjen e disa qelizave nga qafa e mitrës në fund të vaginës. Kampioni dërgohet në një laborator për analizë. Kampioni dërgohet në një laborator për analizë. Nëse konstatohet diçka e tillë, është e mundur të veprohet me shpejtësi duke e kuruar atë apo duke e mbajtur situatën në monitorim.






Përpara konsultës, mund të bëni një dush, por mos lani pjesën e brendëshme të vaginës.

## Ekzaminimi i gjirit

Ky ekzaminim është i thjeshtë dhe pa dhimbje. Ai është shumë i rëndësishëm pasi mund të dallojë ndonjë kokërr apo gjëndër i cili kërkon teste të mëtejshme (ekografi dhe/ose mamografi) për një diagnozë të saktë: kist, fibromë, kancer...

Edhe nëse doktori nuk e sugjeron këtë test gjatë konsultimit, ju mund ta kërkoni atë. Duhet ti tregoni doktorit në rast se ka pasur ndonjë histori kanceri në familjen tuaj.

Nëse merrrni kontraceptivë hormonale (hape, implante, pajisje IUD), vëzhgimi i përvitshëm i gjirit është i nevojshëm.

**Pas moshës 50-vjeçare, një mamografi çdo dy vjet është e nevojshme për të dalluar kancerin e gjirit. Është tërësisht falas me sigurim mjekësor.**

## Depistimi i Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme (IST)

Të pasurit e një IST-je pa ansjë simptomë është e mundur, prandaj ka rëndësi depistimi i rregullt i tyre, me qëllim kurimin dhe shmangien e transmetimit si dhe komplikacionet serioze si shterpësia. Kujdes, vetëm prezervativi mund t'ju mbrojë nga IST-të



# PËRVEÇ KONTROLLIT DUHET TË BËNI KONSULTA SA HERË QË KENI NJË PROBLEM APO PYETJE.

- **SIMPTOMAT TEK GJIRI?** Një gjendër? Pak dhimbje?
- **SIMPTOMAT TEK ORGANET GJENITALE?** Diçka kullon? Kruhet? Mban erë? Shpon? Dhemb disi?
- **PERIODAT QË NUK VIJNË?** Vijnë me dhimbje? Me shumicë? Të çrregullta?
- **KENI NEVOJË PËR KONTRACEPTIVE?** Ka metoda të ndryshme. Gjeni pak kohë për zgjedhur më të mirën për veten tuaj. Mund ta ndryshoni nëse keni dëshirë. Gjinekologu juaj mund t'ju rekomandojë metodën më të përshtatshme për ju.
- **NDËRPRERJA E NJË SHTATZËNËSIE**
- **DONI TË NDËRPRISNI NJË SHTATZËNËSI? JU APO PARTNERI JUAJ JENI SHTERPË?** Mund të vini bashkë me partnerin tuaj.
- **KONTROLL I SHTATZËNËSISË**
- **GJATË MENOPAUZËS,** gjinekologu juaj mund t'ju ndihmojë të përmirësoni mirëqënien tuaj dhe jetën seksuale: afshet, lodhjen, dhimbjet e nyjeve, tharjen vaginale, humbjen e nxitjes seksuale